REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

THIRRJE PËR APLIKIM
2020-07-24 03:30:00

ZGJEDHJET E ANËTARËVE TË GRUPIT TË EKSPERTËVE PËR MASAT KUNDËR TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE (GRETA)

Sekretariati i Mekanizmit të Monitorimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, ka shpallur paraqitjen e kandidaturave nga shtetet palë të Konventës për zgjedhjet e 8 anëtarëve nga 15 anëtarët e Grupit të Ekspertëve për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA). Vendi ynë ka të drejtë të paraqesë jo më shumë se tre kandidatë, që kanë kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara profesionale për të shërbyer në GRETA.
Zgjedhjet do të zhvillohen në takimin e 27-të të Komitetit të Palëve të Konventës së Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, e cila është parashikuar të bëhet në gjysmën e dytë të nëntorit - fillimi i dhjetorit 2020 në Strasburg. Mandati i një anëtari të GRETA është katër vjet, i rinovueshëm një herë.
Në këtë kuadër, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme publikon thirrjen për aplikim për paraqitjen e kandidaturave për Grupin e Ekspertëve GRETA.
Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët:

- Të kenë cilësi të larta morale, të jenë të pavarur dhe të paanshëm.
- Të jenë në dispozicion për t'i shërbyer GRETA-s në mënyrë efektive dhe në cilësinë e tyre individuale.
- Të kenë kompetenca profesionale dhe ekspertizë të njohur në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe njohuri dhe përvojë profesionale në fushat që mbulon Konventa konkretisht:
    - Ekspertë, specialistë, profesionistë, në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore, ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.
    - Specialistë dhe profesioniste për mbrojtjen e fëmijëve, profesionistë që ofrojnë ndihmë juridike, psikologjike ose mjekësore për viktimat e trafikimit
    - Profesionistë në fushën e zbatimit të kuadrit ligjor si: gjyqtarë, inspektorë, specialistë me përvojë pune në fushën e trafikimit.
- Të kenë njohuri shumë të mira të njërës prej gjuhëve zyrtare të Këshillit të Evropës (gjuhën angleze, ose gjuhën frënge).

Afati i dorëzimit të aplikimeve: Data 31 gusht 2020
Aplikimet të dërgohen në adresën elektronike: raportime@mfa.gov.al